



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 21-2008
Prishtinë, 07 tetor 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Selvije Halimi, Kolë Berisha, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Riza Smaka, Ramadan Gashi dhe Reshit Gashi - NDI.

Munguan: Branislav Grbiq, Džezair Murati dhe Lutfi Haziri.

Nga stafi mbështetës i Komisionit në mbledhje ishin të pranishëm: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITES

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 9 shtatorit 2008;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për presidentin e Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Kodin e procedurës penale;
5. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit;
6. Formimi i grupit të punës për hartimin e raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale në Burgun e Dubravës;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Vahide Brahës, avokate nga Prishtina, lidhur me lëndën penale AP-Kz. 393/2006;
8. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit;
9. Shqyrtimi i kërkesës së Institutit të Historisë;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

*Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.
Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 9 shtatorit 2008

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kishin vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për presidentin e Republikës së Kosovës

Kryetari – Lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për presidentin e Republikës së Kosovës e hapi diskutimin. E morën fjalën dhe diskutuan të gjithë anëtarët e Komisionit për projektligjin në fjalë dhe në mbyllje të kësaj pike të rendit të ditës u caktua edhe referuesi, z. Bajram Kosumi, për Projektligjin. Kjo pikë e rendit të ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Kodin e procedurës penale

Kryetari – I paraqiti para Komisionit propozimamendamentet e propozuara në Kodin e procedurës penale. Pas diskutimit konstruktiv, sidomos tek orët e mbajtjes (ndalimit) nga ana e policisë, u miratuan njëzëri propozimamendamentet nga anëtarët e Komisionit.

5. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryetari – E paraqiti para Komisionit propozimin për shqyrtimin e amendamenteve në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Raportuesi i këtij projektligji vuri në pah se te ky projektligj duhet të intervenohet. Me këtë mendim u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit. Të gjithë anëtarët e Komisionit u zotuan se në mbledhjen e ardhshme do t'i kenë të gatshme vërejtjet dhe komentet për këtë projektligj.

6. Formimi i grupit të punës për hartimin e raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale në Burgun e Dubravës

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës kryetari kërkoi të formohej edhe Komisioni që do ta hartonte raportin për vizitën në Burgun e Dubravës. Ky komision u formua në përbërje: Bahri Hyseni, Dzezair Murati, Riza Smaka dhe Reshit Gashi (NDI). Anëtarët Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi javën e ardhshme do ta vizitojnë edhe Gjykatën e Qarkut të Pejës.

7. Shqyrtimi i kërkesës së Vahide Brahës, avokate nga Prishtina, lidhur me lëndën penale AP-Kz. 393/2006

Kryetari – E paraqiti për shqyrtim kërkesën e Vahide Brahës, avokate nga Prishtina, lidhur me lëndën penale Ap-Kz. 393/2006. Lidhur me këtë kërkesë anëtarët e Komisionit vendosën të kërkohej sqarime nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

8. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit

Kryetari – E paraqiti për shqyrtim kërkesën e Këshillit të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit. U vendos që znj. Selviqe Halimi, anëtare Komisionit, ta hartojë një interpretim për këtë çështje.

9. Shqyrtimi i kërkesës së Institutit të Historisë

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Institutit të Historisë. Vendosi që këtë kërkesë t’ia drejtojë Komisioni për Drejta dhe Peticione.

10. Të ndryshme

Komisioni diskutoi për raportin e Komisionit për Komunitete lidhur me propozimin e këtij komisioni që në Projektligjin për noterinë në versionin e gjuhës serbe fjala *notarstvo* të zëvendësohet me *javno beležništvo*. Komisioni e përkrahu këtë amendament.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 00

Procesverbalin e hartoi
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i komisionit

Bahri Hyseni